

VENDIM
Nr. 136, datë 7.6.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “INFO-TELECOM” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.6.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 87/5 prot., datë 4.6.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes,

konstatoi se:

- Shoqëria “Info-Telecom” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 713 prot., datë 2.6.2021, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave, për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “Info-Telecom” sh.p.k., rezulton se subjekti ka kryer pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: “a”, “b”, “c”, “d”, dhe “e”, plotësuar;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: “b”, “c” dhe “d”, plotësuar;
- dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germat: “a” dhe “c”, plotësuar.
- Dokumentacioni që mbetet ende pa u plotësuar tërësisht konsiston në:
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “a”, vërtetim për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore (për shoqëritë e sapokrijuara vërtetim që nuk ka detyrime).

Shoqëria ka depozituar vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve tatimore, por në zbatim të kërkesave të kësaj pike të rregullores, duhet të depozitojë në ERE edhe vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germa “b”, kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare), i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj.

Shoqëria duhet të specifikojë kapitalin që vë në dispozicion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet shoqëria që ta depozitojë atë në ERE brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Info-Telecom” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti